



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT

PROJEKTREZOLUTË

“PËR REFORMËN E POLITIKËS SHTETËRORE PËR DIASPORËN ”

Komisioni për Politikën e Jashtme në mbledhjen e datës 18.07.2018 me cilësinë e komisionit të përhershëm të Kuvendit, bazuar në nenet 18 dhe 32- 38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektrezolutën “Për Reformën e Politikës Shtetërore për Diasporën ”

Projektrezoluta është paraqitur në Kuvend me shkresën nr. 2349 prot ,datë 16.07.2018, nga Nënkomisioni” Për Diasporën dhe Migracionin”.

Deputetët diskutuan për përmbajtjen e projektrezolutës, duke u shprehur për rëndësinë e miratimit të saj. Në diskutimet e tyre vlerësuan hapat e rëndësishëm që janë hedhur në ndërtimin e strukturave të politikës shtetërore për diasporën, miratimin e kuadrit ligjor e cila i kushtohet komuniteteve shqiptare jashtë vendit si dhe rëndësinë e veprimtarisë shtetërore në këtë fushë . Deputetët në diskutimet e tyre bënë disa propozime dhe sugjerime ne lidhje me përmbajtjen e tekstit të projektrezolutës të propozuar nga Nënkomisioni “Për Diasporën dhe Migracionin” të cilat u miratuan nga deputetët e pranishëm në mbledhje.

Në përfundim të diskutimeve, deputetët u shprehën dakord për kalimin e projektrezolutës për miratim në seancë plenare.

Bashkëlidhur projektrezoluta

KRYETARE

MIMI KODHELI

